

LIGJ

Nr. 7836, datë 22.6.1994

PER ÇMIMIN E TOKES BUJQESORE PER EFEKT KOMPENSIMI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton vlerën e tokës bujqësore për efekt të kompensimit në vlerë të ish-pronave personave fizike e juridike që përfitojnë nga ligji nr. 7699, datë 21.4.1993.

KREU II: VLERA E KOMPENSIMIT TE TOKES BUJQESORE

Neni 2*

Masa në vlerë e kompensimit që do të jepet për një ha tokë, pavarësisht nga zëri kadastrai i saj, do të përllogaritet mbi bazën e balotazhit mesatar të tokave në kufijtë kadastralë të njësive administrative.

Kriteret për përcaktimin e balotazhit mesatar të tokave sipas njësive administrative do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3*

Vlera e kompensimit të tokës bujqësore, në mbështetje të nenit 2, është si më poshtë:

Klasat	Vlera në çdo ha në 000/lekë		
	Deri në 15 ha	15 deri 1000 ha	100 deri 1100 ha
Klasa I	280	310	360
Klasa II	244	274	324
Klasa III	210	240	290
Klasa IV	171	201	251
Klasa V	135	165	215
Klasa VI	107	137	187
Klasa VII	62	92	142

Neni 4

Vlerësimi i ullinjve bëhet me rrënjë.

Një rrënjë ulliri për efekt kompensimi vlerësohet me 3000 lekë.

Sipërfaqja e zënë nga çdo rrënjë ulliri llogaritet me 60 m². Diferenca tjetër e sipërfaqes së tokës që mbetet nga zëri kadastral ullahte, vlerësohet tokë bujqësore.

MARREDHENIET E PRONESISE

Ligj nr. 7836, datë 22.6.1994 "Për çmimin e tokës bujqësore për kompensim"

II.1d

Page 1

Neni 5*

Per efekt kompensimi në vlerë të ligjit nr. 7699, datë 21.4.1993, kryhet konvertimi i rrënjëve të pemëve në sipërfaqe toke sipas tabelës përkatëse që i bashkëngjitet këtij ligji.

KREU III: PARAQITJA E PRETENDIMEVE PER KOMPENSIMIN NE VLERE TE TOKES BUJQESORE

Neni 6

Per zbatimin e këtij ligji ngarkohet Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Ky Komitet përcakton strukturat kompetente dhe fillon aktivitetin jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë kompetencat e këtij Komiteti.

Neni 7*

Ish-pronaret ose trashëgimtarët e tyre duhet të paraqesin në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve dokumentacionin përkatës të pronësisë.

Neni 8*

Zyra e kadastrës në rreth, pasi të pasqyrojë në hartën topografike të kufijve kadastralë të njësive administrative pronat e ish-pronarëve, lëshon vërtetimin për çdo pretendues. Në mungesë të dokumentacionit që vërteton ish-pronën, zyra e kadastrës përpilon dhe afishon listën e pretenduesve në njësinë administrative përkatëse. Mbi bazën e një dokumenti zyrtar të lëshuar nga kryepileqësia e fshatit dhe të miratuar e të legalizuar nga këshilli i komunës, zyra e kadastrës mund të pranojë që të pasqyrojë në hartë kërkesën e pretenduesit; kur kërkesa e pretenduesit krijon mbivendosje me pronat e një ish-pronari, zyra e kadastrës i lëshon pretenduesit vërtetim refuzimi. Në qoftë se mbivendosja krijohet midis një ish-pronari me dokumente të rregullta kadastrale ose hipotekore dhe një ish-pronari që ka vërtetuar pronësinë me vërtetim fakti, atëherë komisioni vendos në favor të ish-pronarit me dokumentacion të rregullt. Në këtë rast i interesuari ka të drejtë të bëjë padi në gjykatë kundër zyrës së kadastrës për njëqind të pronësisë. Pronesia do të vërtetohet me vendim gjyqësor në prani të palës kundërshtare kur i interesuari disponon me prove shkresore ose fillesë prove me shkrim.

Neni 9

Ky nen është bashkuar me nenin 8 nga ligji nr. 7982, datë 27.7.1995.

Neni 10

Personave, që në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", ndryshuar me ligjin nr. 7715, datë 26.6.1993, kanë përfituar tokë, por kanë refuzuar ta marrin, kjo sipërfaqe u zbritet nga masa e sipërfaqes për efekt kompensimi.

Neni 11

Strukturat e kompensimit në vlerë për tokën bujqësore shqyrtojnë pretendimet e paraqitura nga ish-pronarët dhe, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, marrin vendimin përkatës.

Vendimi i komisionit i njoftohet me shkrim personit fizik a juridik të interesuar.

Neni 12

Ish-pronari i tokës bujqësore, të cilit i njihet pronësia nga strukturat kompetente, paraqitet për të marrë obligacionin në degën e thesarit në rreth.

KREU IV: DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 13

Kundër vendimit të komisionit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit përkatës, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

MARRREDHENIET E PRONESISE

Ligj nr. 7836, datë 22.6.1994 "Për çmimin e tokës bujqësore për kompensim"

II .1d

Page 3

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 1175, datë 4.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Ndryshime në ligjin nr. 7836, datë 22.6.1994

Akt i ndryshuar:

Ligj	7836	1994	Neni 2	Ndryshime në nen
Ligj	7836	1994	Neni 2	Ndryshime në nen
Ligj	7836	1994	Neni 2	Ndryshime në nen
Ligj	7836	1994	Neni 2	Ndryshime në nen
Ligj	7836	1994	Neni 2	Ndryshime në nen

Akt që ndryshon:

Ligj	7982	1995	Neni 1
Ligj	7982	1995	Neni 2
Ligj	7982	1995	Neni 3
Ligj	7982	1995	Neni 4
Ligj	7982	1995	Neni 5